



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Mbledhja plenare e Kuvendit të Kosovës
P- 005
Prishtinë, më 10 mars 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e mbledhjeve plenare.

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKES SE KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 10 MARS 2011

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 90 deputetë dhe e deklaroi të hapur mbledhjen.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Ai i përkujtoi deputetët se Kuvendi në mbledhjen plenare të mbajtur më 7 mars 2011 ka ngarkuar grupet parlamentare që ta harmonizojnë tekstin e projektrezolutës, në bazë të asaj që ka propozuar Grupi Parlamentar i PDK-së dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, si dhe të diskutimit të kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe Kuvendit t'ia paraqesin për votim tekstin e harmonizuar të Projektrezolutës, në mbledhjen e sotme plenare.

Kryetari propozoi që votimi për Projektrezolutën të radhitet si pika e katërt e rendit të ditës.

Kuvendi miratoi propozimin e kryetarit.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3 mars 2011,
3. Miratimi i Propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare,
4. Votimi i Projektrezolutës për dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Zenun Pajaziti, Haki Demolli, Visar Ymeri, Daut Haradinaj, Bekim Haxhiu, Rita Hajzeraj, Libur Aliu dhe Xhevaire Izmaku. Diskutimet e plota janë dhënë në transkript.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3 mars 2011

Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 3 mars 2011

3. Miratimi i Propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në bazë të nenit 15.1 dhe nenit 63 të Rregullores së Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar për miratim emërtimin, numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare.

Deputeti Xhevdet Neziraj pati vërejtje në përfshirjen e deputetëve nga radha e komuniteteve joshumicë në komisionet parlamentare.

Kryetari hodhi në votim propozimin e Kryesisë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----104,
Kundër----- 6,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E 13 (TREMBËDHJETË) KOMISIONEVE PARLAMENTARE

I.

Formohen 4 (katër) komisione të përhershme, sipas emërimit dhe përbërjes, si në vijim:

I. Komisioni për Buxhet dhe Financa, 11 anëtarë:

1. Safete Hadergjonaj, kryetare (GP – PDK),
2. Naser Osmani, zëvendëskryetar i parë, (GP - LDK),
3. Jelena Bontiq, zëvendëskryetare e dytë (GP – SLS),
4. Latif Gashi, anëtar (GP – PDK),
5. Hasime Krasniqi, anëtare (GP – PDK),
6. Hykmete Bajrami, anëtare (GP - LDK),
7. Sali Asllanaj, anëtar (GP - LDK),
8. Albana Fetoshi, anëtare (GP - VV),
9. Xhevdet Neziraj, anëtar (GP - AAK),
10. Muhamet Mustafa, anëtar (GP – KKR) dhe
11. Duda Balje, anëtare(GP - 6+).

II. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, 12 anëtarë:

1. Sasha Rashiq, kryetar (GP – SLS - nga komuniteti serb),
2. Myzejene Selmani, zëvendëskryetare e parë (GP- KKR- nga komuniteti shumicë),
3. Albert Kinolli, zëvendëskryetar i dytë (GP - 6+ Komuniteti rom),
4. Lumnije Morina, anëtare (GP – PDK- nga komuniteti shumicë),
5. Lirije Kajtazi, anëtare (GP – LDK- nga komuniteti shumicë),
6. Agim Kuleta, anëtar (GP – VV- nga komuniteti shumicë),
7. Jasmina Zhivkoviç, anëtare (nga komuniteti serb),
8. Jelena Bontiq, anëtare (nga komuniteti serb),
9. Petar Miletqi, anëtar (nga komuniteti serb),
10. Mufera Sinik, anëtare (nga komuniteti turk),
11. Rasim Demiri, anëtar (nga komuniteti boshnjak), dhe
12. _____, anëtar (nga komuniteti egjiptian ose ashkali ose goran).

III. Komisioni për Legjislacion, 11 anëtarë,

Nën-komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit,
nga radhët e anëtarëve të Komisionit

1. Arben Gashi, kryetar (GP – LDK),
2. Arsim Bajrami, zëvendëskryetar i parë (GP – PDK),
3. Mufera Sinik, zëvendëskryetare e dytë (GP 6+),
4. Behar Selimi, anëtar (GP – PDK),
5. Halit Krasniqi, anëtar (GP – PDK),
6. Haki Demolli, anëtar (GP - LDK),
7. Armend Zemaj, anëtar (GP - LDK),
8. Albulena Haxhiu, anëtare (G/P - VV),
9. Ardian Gjini, anëtar (GP - AAK),
10. Ibrahim Makolli, anëtar (GP – KKR) dhe
11. Jasmina Zhivkoviq, anëtare (G/P – SLS).

IV. Komisioni për Integritet Evropian, 11 anëtarë.

1. Lutfi Haziri, kryetar (GP - LDK),
2. Xhavit Haliti, zëvendëskryetar i parë (G/P - PDK),
3. Sasha Millosavleviq, zëvendëskryetar i dytë (G/P - SLS),
4. Fatmir Limaj, anëtar (GP – PDK),
5. Blerta Deliu-Kodra, anëtare (G/P – PDK),
6. Vjosa Osmani, anëtare (GP - LDK),
7. Nekibe Kelmendi, anëtare (GP - LDK),
8. Alma Lama, anëtare (GP - VV),
9. Blerim Shala, anëtar (GP - AAK),
10. Suzan Novoberdaliu, anëtare (GP – KKR) dhe
11. Albert Kinolli, anëtar (GP - 6+).

II.

Formohen 9 (nëntë) komisione funksionale, sipas emërimit dhe përbërjes, si në vijim:

I. Komisioni për Punë të Jashtme, 9 anëtarë:

1. Albin Kurti, kryetar (GP - VV),
2. Hydajet Hyseni, zëvendëskryetar i parë (GP - PDK),
3. Enis Kervan, zëvendëskryetar i dytë (GP – 6+),
4. Shaip Muja, anëtar (GP – PDK),
5. Skender Hyseni, anëtar (GP - LDK),
6. Sabri Hamiti, anëtar (GP - LDK),
7. Donika Kadaj- Bujupi, anëtare (GP- AAK),
8. Amir Ahmeti, anëtar (GP – KKR) dhe
9. Petar Miletqi, anëtar (GP – SLS).

II. Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, 11 anëtarë:

1. Idriz Vehapi, kryetar (GP – PDK),
2. Eqrem Kryeziu, zëvendëskryetar i parë (GP – LDK),
3. Enis Kervan, zëvendëskryetar i dytë (GP - 6+),
4. Ramë Vataj, anëtar (GP – PDK),
5. Xhevahire Izmaqu, anëtare (GP – PDK),
6. Lirije Kajtazi, anëtare (GP – LDK),
7. Sadri Ferati, anëtar (GP - LDK),
8. Afrim Kasolli, anëtar (GP - VV),
9. Teuta Haxhiu, anëtare (GP - AAK),
10. Jeton Sfirca, anëtar (GP – KKR) dhe
11. Vesimir Saviq, anëtar (GP – SLS).

III. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, 11 anëtarë:

1. Zenun Pajaziti, kryetar (GP – PDK),
2. Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare e parë (GP – LDK),
3. Fikrim Damka, zëvendëskryetar i dytë (GP - 6+),
4. Sala Berisha - Shala, anëtare (G/P – PDK),
5. Berat Buzhala, anëtar (GP – PDK),
6. Lutfi Zharku, anëtar (GP - LDK),
7. Hashim Deshishku, anëtar (GP - LDK),
8. Visar Ymeri, anëtar (GP - VV),
9. Ramiz Kelmendi, anëtar (GP - AAK),
10. Myzejene Selmani, anëtare (GP – KKR) dhe
11. Biserka Kostiq, anëtare (GP – SLS).

IV. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, 9 anëtarë:

1. Fikrim Damka, kryetar, (GP - 6+),
2. Time Kadriaj, zëvendëskryetare e parë (GP - AAK),
3. Sasha Gjokiq, zëvendëskryetar i dytë (GP – SLS),
4. Flora Brovina, anëtare (GP – PDK),
5. Salihe Mustafa, anëtare (GP – PDK),
6. Bahri Thaçi, anëtar (GP - LDK),
7. Nazane Breca, anëtare (GP - LDK),
8. Aurora Bakalli, anëtare (GP - VV),
9. Gezim Kelmendi, anëtar (GP – KKR) .

V. Komisioni për Bujqësi, Pylltari , Mjedis e Planifikim Hapësinor, 9 anëtarë:

1. Nait Hasani, kryetar (GP – PDK),
2. Liburn Aliu, zëvendëskryetar i parë (GP - VV),
3. Rasim Demiri, zëvendëskryetar i dytë (GP - 6+),
4. Nijazi Idrizi, anëtar (GP – PDK),
5. Salih Morina, anëtar (GP - LDK),
6. Afërdita Berisha- Shaqiri, anëtare (GP - LDK),
7. Daut Haradinaj, anëtar (GP - AAK),
8. Sevdije Lama, anëtare (GP – KKR) dhe
9. Etem Arifi, anëtar (GP – SLS).

VI. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 9 anëtarë:

1. Ahmet Isufi, kryetar (GP - AAK),
2. Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë (GP - VV),
3. Goran Marinković, zëvendëskryetar i dytë (GP – SLS),
4. Fatmir Xhelili , anëtar (GP – PDK),
5. Ganimete Musliu, anëtare (GP – PDK),
6. Anton Quni, anëtar (GP - LDK),
7. Vjollca Krasniqi, anëtare (GP - LDK),
8. Ibrahim Makolli, anëtar (GP – KKR) dhe
9. Rasim Demiri, anëtar (GP - 6+).

VII. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjensionit Kosovar për Inteligjencë, 9 anëtarë:

1. Florin Krasniqi, kryetar (GP - VV),
2. Fadil Demaku, zëvendëskryetar i parë (GP - PDK),
3. Boban Todorović, zëvendëskryetar i dytë (GP – SLS),
4. Bekim Haxhiu, anëtar (GP – PDK),
5. Haki Demolli, anëtar (GP - LDK),
6. Imri Ahmeti, anëtar (GP - LDK),
7. Burim Ramadani, anëtar (GP - AAK),
8. Ukë Rugova, anëtar (GP – KKR) dhe
9. Duda Balje, anëtare (GP - 6+).

VIII. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, 9 anëtarë:

1. Ali Sadria, kryetar (GP – LDK),
2. Ramiz Lladrovci, zëvendëskryetar i parë (G/P - PDK),
3. Mursel Halili, zëvendëskryetar i dytë (G/P – SLS),
4. Valbona Dibra, anëtare (GP – PDK),
5. Armend Zemaj, anëtar (GP – LDK),
6. Afrim Hoti, anëtar (GP - VV),
7. Bali Muharremaj, anëtar (GP -AAK),
8. Muhamet Mustafa, anëtar (GP – KKR) dhe
9. Albert Kinolli, anëtar (GP - 6 +).

IX. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, 9 anëtarë:

1. Suzan Novoberdaliu, kryetare (GP – KKR),
2. Rita Hajzeraj-Beqaj, zëvendëskryetare e parë (GP – LDK),
3. Biserka Kostiq, zëvendëskryetar i dytë (GP – SLS),
4. Justina Shiroka- Pula, anëtare (GP – PDK),
5. Kurtan Kajtazi, anëtar (GP – PDK),
6. Ismet Beqiri, anëtar (GP – LDK),
7. Albana Gashi, anëtare (GP - VV),
8. Kymete Bajraktari, anëtare (GP - AAK) dhe
9. Duda Balje, anëtare (GP - 6 +).

III.

Fushëveprimi i komisioneve parlamentare sipas Shtojcës nr. 2 të Rregullores së Kuvendit duhet të harmonizohet në pajtim me këtë vendim, duke i shtuar Komisionit për Legjislacion edhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

4. Votimi i Projektrezolutës për dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e propozuesit të Projektrezolutës, ta marrë fjalën.

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, **Adem Grabovci** tha se përfaqësuesit e grupeve parlamentare, në bazë të përfundimit të mbledhjes plenare të 7 marsit 2011, kanë mbajtur dy mbledhje me qëllim të harmonizimit të tekstit të Projektrezolutës. Në tekstin përfundimtar të saj janë përfshirë edhe disa propozime të partive opozitare, por në fund ato nuk e kanë nënshkruar tekstin e projektrezolutës.

Kryetari hodhi në votim tekstin e Projektrezolutës. Rezultati i votimi ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër-----48,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi këtë

R E Z O L U T Ë

Për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet dialogun midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane, Kosovës dhe Serbisë, për çështje praktike, në interes të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe të avancimit të agjendës evropiane për të dy shtetet dhe për rajonin.

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon parimin që dialogu midis dy palëve të lehtësohet nga BE dhe SHBA-të.
3. Dialogu i Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë i përgatitur mirë, me agjendë të qartë dhe të përcaktuar paraprakisht, në marrëveshje ndërmjet palëve dialoguese, duke përfshirë edhe lehtësuesit e dialogut.
4. Agjenda e dialogut do të përfshijë vetëm çështjet teknike të interesit të përbashkët, pa prekur në asnjë rast sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetues të Kosovës.
5. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës që t’ia paraqetëp Kuvendit të Republikës së Kosovës dokumentin themelor të dialogut brenda afatit ligjor.
6. E emëruara nga kryeministri, udhëheqja e delegacionit të Republikës së Kosovës për dialogun me Republikën e Serbisë, do të informojë në baza të rregullta Komisionin për Politikë të Jashtme dhe komisionet tjera përkatëse të Kuvendit të Kosovës dhe do të raportojë, edhe në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës.
7. Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh vullnetin e qytetarëve të Kosovës për të vendosur marrëdhënie të mira fqinjësore me Republikën e Serbisë, në të mirë të dy vendeve tona, popujve tanë, të integriteteve evropiane dhe të stabilitetit e prosperitetit të përgjithshëm të rajonit.
8. Kuvendi i Republikës së Kosovës riafirmon qëndrimin se bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe dialogu janë kontribut për paqen e stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të vendeve tona dhe të rajonit në përgjithësi si dhe për përshpejtimin e integriteteve evropiane dhe evro-atlantike.
9. Kuvendi i Republikës së Kosovës e rikonfirmon të drejtën kushtetuese për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që i nënshkruan Qeveria e Republikës së Kosovës

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 11 : 50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale